

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

“Supervizion punimesh Ndërtim rruga Kashar - Nyja Vaqarr Faza III”

Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur - Shërbime - prokurim me mjete elektronike”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
71247000-1 “Mbikëqyrja e punës së ndërtimit”

VLERA E FONDIT LIMIT:

1. Fondi limit: 12,982,473.66 (dymbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) **Lekë, pa TVSH.**

Në bazë të Nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024, Autoriteti/Enti Kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit është e parashikuar në Buxhetin e Shtetit për vitet 2026-2028, për Autoritetin Rrugor Shqiptar sipas shkresës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 2741/3 prot, datë 15.04.2026.

✓ Në DST është përcaktuar:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti / enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

☐

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspektet kritike, që ndalohet mbështetja:

- Për të provuar përvojën e mëparshme (**shërbime të ngjashme**):
 - Pika 2.3.1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”
- Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (**licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës**):
 - Pika 2.3.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

➤ **Në lidhje me pikën 2.16 të DST-ve argumentojmë:**

Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë nuk mund të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera për të provuar përvojën e mëparshme në shërbime të ngjashme (pika 2.3.1) dhe përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, konkretisht licencën profesionale të shoqërisë (pika 2.3.2), pasi këto përbëjnë aspekte kritike të realizimit të kontratës.

Objekti i kësaj procedure është **mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit**, shërbim i cili kërkon përgjegjësi të drejtpërdrejtë profesionale, teknike dhe ligjore nga subjekti që do të kryejë mbikëqyrjen. Përvoja në shërbime të ngjashme dhe licenca profesionale janë elementë thelbësorë që garantojnë se operatori ekonomik disponon ekspertizën, organizimin dhe kapacitetin e nevojshëm për të monitoruar cilësinë e punimeve, zbatimin e projektit, respektimin e standardeve teknike, të legjislacionit në fuqi, si dhe administrimin korrekt të kontratës së mbikëqyrjes.

Lejimi i mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të treta për këto kritere do të çenonte sigurinë se operatori që lidh kontratën disponon realisht kapacitetet profesionale dhe eksperiencën e kërkuar për realizimin e shërbimit, duke rritur riskun për mospërmbushje cilësore të detyrimeve kontraktore.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se përvoja e ngjashme dhe licenca profesionale duhet të zotërohen nga vetë operatori ekonomik, ose në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, nga anëtari që do të realizojë pjesën përkatëse të shërbimit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit të prokurimit publik që lejojnë përcaktimin e detyrave ose aspekteve kritike të kontratës që duhet të përmbushen drejtpërdrejt nga kontraktori.

✓ Në DST është përcaktuar:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A)¹ **Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto** X

Sipas rëndësisë:

Çmimi ☐ pikët 50

Propozimi Teknik ☐ pikët 50

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe - Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu - Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç - Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

Kriteret e Vlerësimit	Pikët
(i) Përvoja për Shërbime të Ngjashme të Konsulentit	[0-10]
Nënkriteret	
i/a Përvoja për punë të ngjashme	40-80%
Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.	
i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë	10-20%

¹ Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.

Operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

(ii) Metodologjia e Propozuar [20-30]

Nënkriteret

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia	[20-30%]
ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit	[30-40%]
ii.c. Organizimi i Stafit	[20-30%]

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia: Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme, duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

ii/c. Organizimi dhe Staf: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar

[20-50]

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

- a- Kualifikim i përgjithshëm [5-20%]
- b- Eksperienca në fushën përkatëse [30-80 %]

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

(iv) Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet) [0-10]

Nëse transferimi i njohurive nuk aplikohet (nuk kërkohet), atëherë pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t'i shtohen kriterit “Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar”.

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.5)$

Pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.5)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

Oferta më e mirë = $X + Y$

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Argumentimi:

Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kriter përzgjedhjeje **"Ofertën ekonomikisht më të favorshme, bazuar në kosto"**, duke vlerësuar ofertat mbi bazën e kombinimit të cilësisë teknike dhe ofertës ekonomike, me peshë **50% për Propozimin Teknik dhe 50% për Propozimin Ekonomik**.

Ky kriter është përzgjedhur duke marrë në konsideratë natyrën e kontratës, e cila ka si objekt **shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve të zbatimit**. Ky është një shërbim intelektual dhe profesional, ku cilësia e realizimit të shërbimit ndikon drejtpërdrejt në kontrollin e cilësisë së punimeve, respektimin e projektit, afateve kontraktore, standardeve teknike dhe legjislacionit në fuqi. Për këtë arsye, përzgjedhja nuk mund të bazohet vetëm në çmimin më të ulët, por duhet të garantojë edhe nivelin e kërkuar të ekspertizës teknike.

Kriteret e vlerësimit teknik janë ndërtuar në mënyrë që të identifikojnë ofertën që paraqet kapacitetin më të mirë për realizimin e kontratës, duke vlerësuar:

- përvojën e operatorit ekonomik në realizimin e shërbimeve të ngjashme, si tregues i aftësisë për të përballuar kontrata me kompleksitet të ngjashëm;
- metodologjinë e propozuar, përfaqshjen teknike, planin e punës dhe organizimin e shërbimit, të cilat demonstronjë kuptimin e objektit të kontratës dhe mënyrën e organizimit të mbikëqyrjes;
- kualifikimet dhe eksperiencën e stafit kryesor të propozuar, duke qenë se realizimi i kontratës mbështetet në mënyrë të drejtpërdrejtë në ekspertizën profesionale të inxhinierëve dhe specialistëve që do të angazhohen.

Shpërndarja e pikëve ndërmjet nënkritereve është bërë në mënyrë proporcionale me rëndësinë që secili element ka në realizimin me sukses të shërbimit të mbikëqyrjes. Në veçanti, peshë të konsiderueshme i është dhënë metodologjisë së zbatimit dhe kualifikimit të stafit, pasi këto elemente ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e kontrollit teknik të punimeve, menaxhimin e situatave të paparashikuara gjatë zbatimit të kontratës dhe garantimin e interesit publik.

Formula e vlerësimit siguron një ekuilibër ndërmjet cilësisë dhe kostos, duke mundësuar përzgjedhjen e ofertës që ofron raportin më të mirë cilësi-çmim, në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe përdorimit me efektivitet të fondeve publike.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 10;**
- b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**
- c. Formularin e Ofertës, **sipas Shtojcës 1;**
- d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, **sipas Shtojcës 2**

Argumentimi:

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar në DST paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Sigurimit të Ofertës, Formularit të Ofertës dhe Listës së Çmimeve sipas shtojcave përkatëse të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Megjithëse Formulari i Ofertës dhe Lista e Çmimeve janë pjesë përbërëse e DST-ve, përfshirja e tyre në këtë pikë është bërë për qëllime qartësie, transparence dhe administrimi korrekt të procedurës, me synim evidentimin e dokumenteve kryesore që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë në momentin e dorëzimit të ofertës.

Kjo mënyrë formulimi nuk shton kërkesa të reja kualifikimi dhe nuk krijon barriera për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, por shërben vetëm për të rikujtuar detyrimin për paraqitjen e dokumenteve të domosdoshme që garantojnë vlefshmërinë, krahasueshmërinë dhe vlerësimin korrekt të ofertave.

Përvoja e Autoritetit Kontraktor në administrimin e procedurave të prokurimit ka evidentuar raste të mosparaqitjes ose paraqitjes së paplotë të këtyre dokumenteve nga operatorët ekonomikë, çka ka sjellë vështirësi në procesin e vlerësimit të ofertave.

Për këtë arsye, evidentimi i tyre në mënyrë të veçantë synon vetëm garantimin e paraqitjes së plotë të dokumentacionit të ofertës dhe zhvillimin normal të procedurës së prokurimit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Sipas Shtojcës 10

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e kapacitetit profesional sipas Shtojcës 10 është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i

ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Përmes Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, operatori ekonomik deklaron përmbushjen e kërkesave që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë profesionale, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Kjo kërkesë i shërben verifikimit paraprak të aftësisë profesionale të operatorëve ekonomikë për të ushtruar ligjërisht aktivitetin objekt prokurimi dhe është në përputhje me natyrën e kontratës dhe kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës (vlera e fondit limit).

Argumentimi:

Kërkesa që operatorët ekonomikë të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga këto vite të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës, është vendosur në mbështetje të *Nenit 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe Nenit 43, pika 1 dhe 2, gërma “a”, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

Ky kriter është vendosur për të provuar se operatori ekonomik disponon kapacitetin e nevojshëm financiar dhe ekonomik për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve kërkon angazhimin e vazhdueshëm të personelit të kualifikuar, mbulimin e shpenzimeve operative dhe administrimin financiar të kontratës përgjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Kërkesa për një xhiro vjetore në masën e fondit limit është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, pasi nuk tejkalon vlerën e kontratës dhe synon të garantojë që operatori ekonomik ka stabilitet financiar dhe aftësi për të përballuar detyrimet kontraktore pa krijuar rrezik për ndërprerjen ose realizimin jo cilësor të shërbimit.

Gjithashtu, fakti që kërkohet plotësimi i këtij niveli të xhiros vetëm për një nga tre vitet financiare të kërkuara (2023-2025) e bën kriterin më pak kufizues për konkurrencën, duke u dhënë mundësi operatorëve ekonomikë që kanë pasur performancë të mirë ekonomike në secilin prej këtyre viteve të marrin pjesë në procedurë. Për rrjedhojë, kriteri është objektiv, proporcional me natyrën dhe vlerën e kontratës dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara të konkurrencës.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025** (Bilancet të parqiten konform parashikimit të *Ligjit Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 është vendosur në mbështetje të *Nenit 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

Ky kriter synon të verifikojë gjendjen ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë, si dhe aftësinë e tyre për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga realizimi i kontratës. Duke qenë se objekti i prokurimit konsiston në shërbime studim-projektimi me rëndësi të veçantë për infrastrukturën rrugore, Autoriteti Kontraktor duhet të sigurohet që operatorët pjesëmarrës disponojnë qëndrueshmëri financiare dhe kapacitet të mjaftueshëm ekonomik për realizimin e kontratës.

Kërkesa që bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme të mos paraqesin raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit është vendosur për të provuar një gjendje financiare të shëndoshë dhe për të minimizuar rrezikun e vështirësive financiare gjatë ekzekutimit të kontratës.

Përcaktimi i viteve financiare 2023, 2024 dhe 2025 është bërë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe kontabël në fuqi, referuar *Ligjit Nr. 9/2025 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, Udhëzimit të Përgjithshëm Nr. 26, datë 08.09.2023, i ndryshuar, si dhe Ligjit Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, të cilat përcaktojnë detyrimin për hartimin dhe depozitimin e pasqyrave financiare vjetore.*

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale.

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 40 % të vlerës** së fondit të limitit të kësaj kontrate realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

-Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

-Fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Ky kriter është vendosur për të garantuar se operatori ekonomik disponon eksperiencën dhe aftësinë profesionale të nevojshme për realizimin e shërbimit objekt prokurimi. Mbikëqyrja e punimeve të rikonstruksionit të rrugës është një shërbim teknik i specializuar, i cili kërkon njohuri të konsoliduara në administrimin e kontratave të ndërtimit, kontrollin e cilësisë së punimeve, verifikimin e zbatimit të projektit, respektimin e specifikimeve teknike, standardeve të ndërtimit dhe legjislacionit në fuqi.

Vlera minimale e kërkuar prej **40% të fondit limit** është përcaktuar në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe është e mjaftueshme për të provuar se operatori ekonomik ka realizuar me sukses kontrata të ngjashme, pa vendosur kërkesa të tepërta që mund të kufizojnë konkurrencën. Ky nivel demonstroi se operatori ka administruar shërbime me kompleksitet dhe përgjegjësi të krahasueshme me objektin e kësaj kontrate.

Periodha referuese prej **tre viteve të fundit** është vendosur për të siguruar që përvoja e paraqitur është aktuale dhe reflekton kapacitetet reale të operatorit ekonomik në kushtet e tregut dhe të legjislacionit në fuqi.

Dokumentacioni i kërkuar për vërtetimin e përvojës, përkatësisht vërtetimet e lëshuara nga autoritetet kontraktore për kontratat e sektorit publik dhe faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat, është përcaktuar për të garantuar verifikueshmërinë, autenticitetin dhe realizimin efektiv të shërbimeve të deklaruara, duke siguruar një vlerësim objektiv dhe të barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme **për mbikëqyrje** të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1	Punime gjurmimi në tokë
2	NP-4	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
3	NP-5	Punime nëntokësore, ura, vepra arti
4	NP-9	Punime mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime
5	NP-11	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
6	NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit
7	NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve
8	NS-6	Sinjalistika rrugore jondriçuese
9	NS-7	Barriera dhe mbrojtja rrugore
10	NS-18	Punime topogjeodezike

Argumentimi:

Kërkesa për disponimin e kësaj licence është e domosdoshme, pasi objekti i prokurimit konsiston në **mbikëqyrjen e punimeve të zbatimit**, veprimtari e cila, sipas legjislacionit në fuqi, mund të ushtrohet vetëm nga subjekte të licencuara.

Kategoritë e licencës janë përcaktuar duke u bazuar në natyrën dhe komponentët teknikë të projektit që do të mbikëqyret, konkretisht:

NP-1 – Punime gjurmimi në tokë

Kjo kategori kërkohet për shkak se realizimi i një veprë rrugore përfshin punime të lidhura me gërmimin, skarifikimin, hapjen dhe sistemimin e trupit të rrugës, si dhe punime të tjera të lëvizjes së dherave. Supervizori duhet të jetë në gjendje të kontrollojë zbatimin e këtyre punimeve sipas niveleve, kuotave, seksioneve tërthore dhe kërkesave teknike të projektit, si dhe cilësinë dhe mënyrën e realizimit të tyre.

NP-4 – Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale

Kjo është kategori drejtpërdrejt e lidhur me objektin e prokurimit, pasi shërbimi i kërkuar ka për objekt supervizionin e punimeve për ndërtimin e një rruge. Disponimi i kësaj kategorie garanton që operatori ekonomik ka kapacitetin profesional për të ushtruar mbikëqyrjen e punimeve specifike të infrastrukturës rrugore, duke përfshirë kontrollin e zbatimit të shtresave rrugore, parametrave gjeometrikë, materialeve, mënyrës së ndërtimit dhe përputhshmërisë së punimeve me projektin dhe specifikimet teknike.

NP-5 – Punime nëntokësore, ura, vepra arti

Kjo kategori kërkohet në funksion të komponentëve të mundshëm të veprës rrugore që lidhen me ura, vepra arti, tombino, struktura mbajtëse dhe elementë të tjerë të infrastrukturës së rrugës. Mbikëqyrja e këtyre punimeve kërkon kompetencë profesionale për kontrollin e zbatimit të elementeve konstruktive, parametrave teknikë, materialeve dhe procedurave të ndërtimit, sipas projektit të miratuar.

NP-9 – Punime mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime

Kjo kategori lidhet me komponentët hidroteknikë dhe të drenazhimit që mund të jenë pjesë përbërëse e infrastrukturës rrugore, veçanërisht në rastin e kalimeve të ujërave, mbrojtjes nga erozioni, kanaleve, tombinove, sistemeve të kullimit dhe veprave të tjera për administrimin dhe disiplinimin e ujërave. Supervizimi i këtyre punimeve kërkon kontroll të posaçëm të zbatimit të tyre, për të garantuar funksionimin dhe qëndrueshmërinë e veprës rrugore.

NP-11 – Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë

Kjo kategori lidhet me punimet elektrike që mund të jenë pjesë e infrastrukturës së rrugës, veçanërisht në rastet kur projekti përfshin furnizim me energji, linja elektrike, kabina, nënstacione apo infrastruktura të tjera të nevojshme për funksionimin e elementeve të rrugës. Disponimi i kësaj kategorie mundëson kontrollin profesional të zbatimit të këtyre punimeve dhe të përputhshmërisë së tyre me projektin dhe kërkesat teknike.

NP-12 – Punime të inxhinierisë së mjedisit

Kjo kategori kërkohet për komponentët e projektit që lidhen me masat dhe ndërhyrjet për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të veprës, si dhe për elementet teknike që synojnë minimizimin e ndikimeve mjedisore. Në kuadër të supervizionit, është e nevojshme të kontrollohet zbatimi i masave mjedisore të përcaktuara në projekt dhe dokumentet përkatëse të kontratës.

NS-1 – Punime për prishjen e ndërtimeve

Kjo kategori justifikohet në rastet kur realizimi i veprës rrugore kërkon prishjen e ndërtimeve ekzistuese, strukturave, elementeve të infrastrukturës ose objekteve të tjera që ndodhen në gjurmën e projektit. Mbikëqyrja e këtyre punimeve është e nevojshme për të garantuar që prishjet kryhen në përputhje me projektin, kërkesat e sigurisë dhe kushtet teknike.

NS-6 – Sinjalistika rrugore jondriçuese

Kjo kategori lidhet drejtpërdrejt me elementët e sigurisë dhe orientimit të trafikut rrugor, si sinjalistika vertikale, tabelat, shenjat dhe elementët e tjerë jondriçues të sinjalizimit. Supervizimi duhet të verifikojë pozicionimin, përmasat, materialet, reflektivitetin dhe zbatimin e tyre në përputhje me projektin dhe standardet teknike të përcaktuara.

NS-7 – Barriera dhe mbrojtja rrugore

Kjo kategori është e lidhur me elementet e sigurisë rrugore, përfshirë barrierat mbrojtëse, parmakët dhe sistemet e tjera të mbrojtjes së përdoruesve të rrugës. Kërkesa justifikohet nga nevoja që supervizori të ketë kompetencën profesionale për të kontrolluar vendosjen, ankorimin, materialet dhe parametrat teknikë të këtyre elementeve, sipas projektit dhe kërkesave të sigurisë rrugore.

NS-18 – Punime topogjeodezike

Kjo kategori është e nevojshme për shkak të rëndësisë së kontrollit topografik dhe gjeodezik gjatë zbatimit të një vepre rrugore. Supervizimi kërkon verifikimin e aksit të rrugës, kuotave, pjerrësive, niveleve, seksioneve tërthore, volumit të punimeve dhe përputhshmërisë së pozicionimit të veprës me projektin e zbatimit. Për këtë arsye, kompetenca në punimet topogjeodezike është e lidhur drejtpërdrejt me kontrollin teknik të saktë të punimeve.

Në përfundim, kërkesa për kategoritë e mësipërme të licencës është përcaktuar në funksion të **komponentëve konkretë të veprës që do të mbikëqyret** dhe synon të sigurojë që operatori ekonomik të disponojë kapacitetet profesionale të nevojshme për ushtrimin e plotë dhe cilësor të shërbimit të supervizionit.

Këto kërkesa lidhen në mënyrë proporcionale me objektin e kontratës dhe me përgjegjësitë që do të ketë supervizori gjatë kontrollit të punimeve të zbatimit, duke përfshirë kontrollin e cilësisë, volumit, parametrave teknikë, materialeve, respektimit të projektit dhe kërkesave të sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Përcaktimi i kategorive të licencës nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garantimin e kapacitetit teknik dhe profesional të nevojshëm për mbikëqyrjen e të gjitha komponentëve të veprës rrugore që përfshihen në objektin e kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **7 (shtatë) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për muajin **Korrik 2026**, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 10.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin **Korrik 2026**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin **Korrik 2026**.

Argumentimi:

"Kërkesa për disponimin e një numri minimal prej 7 (shtatë) punonjësish është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se operatori ekonomik duhet të disponojë një kapacitet minimal njerëzor, i cili garanton organizimin dhe realizimin në kohë dhe me cilësi të shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Numri minimal prej 7 (shtatë) punonjësish është kërkuar për të provuar se operatori ekonomik ka një strukturë organizative funksionale dhe burime njerëzore të mjaftueshme për të përballuar angazhimet kontraktore, duke siguruar vazhdimësinë e shërbimit, zëvendësimin e stafit në rast nevojë, mbështetjen administrative dhe teknike, si dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktore në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit.

Ky kriter është në raport dhe proporcional me natyrën, kompleksitetin dhe kohëzgjatjen e kontratës dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi synon vetëm të verifikojë kapacitetin organizativ të operatorit ekonomik. "Kërkesa për disponimin e minimalisht 7 (shtatë) punonjësve është vendosur duke u bazuar edhe në faktin se personeli i nevojshëm për realizimin e këtij shërbimi është i njëjtë me atë

të parashikuar në procedurën e prokurimit për zbatimin e punimeve. Duke qenë se shërbimi i mbikëqyrjes zhvillohet paralelisht me zbatimin e punimeve dhe kërkon mbështetje të vazhdueshme teknike e administrative, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky numër punonjësish është i domosdoshëm, proporcional dhe garanton kapacitetin e operatorit ekonomik për përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 *Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:*

- SSH EN ISO 9001:2015 *Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë*
- SSH EN ISO 14001:2026 *Sistemet e Menaxhimit Mjedisor*
- SSH EN ISO 45001:2023 *Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e certifikatave të sistemeve të menaxhimit është vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Duke qenë se objekti i kontratës është mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit, Autoriteti Kontraktor vlerëson se operatori ekonomik duhet të disponojë sisteme të certifikuara të menaxhimit, të cilat garantojnë organizimin, kontrollin dhe realizimin e shërbimit në përputhje me standardet e cilësisë, mbrojtjes së mjedisit, si dhe të shëndetit e sigurisë në punë.

- **SSH EN ISO 9001:2015** kërkohet për të garantuar zbatimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të cilësisë në ofrimin e shërbimit të mbikëqyrjes.
- **SSH EN ISO 14001:2026** kërkohet për të siguruar që operatori ekonomik zbaton procedura të menaxhimit mjedisor gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij dhe në monitorimin e zbatimit të punimeve.

- **SSH EN ISO 45001:2023** kërkohet për të garantuar që operatori ekonomik administron në mënyrë të përshtatshme çështjet e shëndetit dhe sigurisë në punë të personelit të angazhuar në realizimin e shërbimit.

Këto certifikime përbëjnë dëshmi të kapaciteteve organizative dhe procedurale të operatorit ekonomik dhe janë në përputhje me objektin, kompleksitetin dhe rëndësinë e shërbimeve që do të realizohen. Për rrjedhojë, kërkesa konsiderohet e nevojshme, proporcionale dhe e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit.

Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar duhet të disponojë certifikatat përkatëse në funksion të pjesës së kontratës që do të realizojë, me qëllim garantimin e përmbushjes së standardeve të kërkuara për të gjitha shërbimet objekt prokurimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termet e Referencës janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me natyrën, qëllimin, objektin dhe kompleksitetin e shërbimit që do të prokurohet, duke përcaktuar në mënyrë të qartë kërkesat teknike, detyrat dhe përgjegjësitë e operatorit ekonomik, mënyrën e realizimit të shërbimit, rezultatet e pritshme dhe standardet që duhet të përmbushen gjatë zbatimit të kontratës. Hartimi i Termave të Referencës është mbështetur në nevojat konkrete të Autoritetit Kontraktor për sigurimin e një shërbimi profesional dhe cilësor të mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit, me qëllim garantimin e realizimit të punimeve në përputhje me projektin e miratuar, specifikimet teknike, kushtet e kontratës së punimeve, afatet kontraktore, standardet teknike dhe legjislacionin në fuqi.

Kërkesat e përcaktuara në Termat e Referencës janë hartuar në mënyrë të qartë, objektive, të matshme dhe proporcionale me objektin e prokurimit, duke respektuar parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, proporcionalitetit dhe nxitjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Në hartimin e Termave të Referencës janë mbajtur parasysh dispozitat e Ligjit Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, përfshirë VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, për sa i përket përcaktimit të kërkesave dhe kushteve të lidhura me objektin e kontratës dhe hartimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit.

Gjithashtu, Termat e Referencës janë hartuar në respektim të kërkesave të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, si dhe të akteve nënligjore, rregullave dhe standardeve teknike në fuqi që lidhen me procesin e projektimit, zbatimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit.

Përcaktimi i kërkesave teknike dhe profesionale në Termat e Referencës synon të garantojë që operatori ekonomik që do të kontraktohet të disponojë kapacitetet dhe ekspertizën e nevojshme për realizimin e shërbimit të mbikëqyrjes, duke siguruar kontrollin e cilësisë së punimeve, respektimin e projektit dhe specifikimeve teknike,